

DOCUMENT TYPE **Internal document**

PLACE **European University of Tirana |
Tirana | ALBANIA**



FINAC

FINancial management,
Accounting & Controlling
in public administration

**Financial Management, Accounting & Controlling curricula
development for capacity building of public administration**

**Report on the implementation of Professional Master Audit –
In Albanian**

Done in Tirana, 9th May 2019

Updated, 11th July 2019



FINAC
FINancial management,
Accounting & Controlling
in public administration



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

*This project has been funded with support from the European Commission.
This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any
use which may be made of the information contained therein*


1. Hapja, akreditimi dhe regjistrimet në programin Master Profesional 'Audit'

Në kuadër të projektit FINAC, Universiteti Europian i Tiranës si një ndër partnerët në këtë projekt, ka hapur një program të ri studimi të ciklit të dytë, Master Profesional 'Audit'. Programi ofrohet në gjuhën shqipe, me një kohëzgjatje prej një viti akademik dhe ofrohet me 60 ECTS. Hapja e programit është bërë me Urdhrin e Ministrit për Arsimin, Sportin dhe Rininë, nr. 684, datë 12.10.2018. Bazuar në legjislacioni për arsimin e lartë, ky program do t'i nënshtrohet procedurave të akreditimit, brenda vitit akademik 2018 – 2019. Për këtë arsye, UET ka depozituar kërkesën zyrtare për fillimin e procedurave të akreditimit të programit, nëpërmjet shkresës nr. 32, datë 20.02.2019, drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Aktualisht, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe Dosjen e Vetëvlerësimit e cila i është dërguar ASCAL, nëpërmjet shkresës Nr.32/1, datë 11.07.2019.

Në vitin akademik 2018 – 2019, në programin Master Profesional 'Audit' janë regjistruar në total 42 studentë. Studentët e regjistruar në këtë program studimi kanë pasur mundësinë të zgjedhin një prej pesë profileve të programit:

1. Auditim dhe Menaxhim Risku;
2. Auditim i Institucioneve Financiare;
3. Kontabilitet dhe Raportim Financiar;
4. Administrim Publik;
5. Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh.

Shpërndarja e studentëve sipas profilit të përzgjedhur është si më poshtë vijon:



Sikurse vihet re nga grafiku i mësipërm, profilet më të përzgjedhur nga studentët e regjistruar në programin Master Profesional 'Audit' janë profilet: Auditim dhe Menaxhim risku, sikurse dhe profili Administrim Publik, në të cilët janë regjistruar respektivisht nga 12 studentë ose 29 % e totalit. Këto dy profile të marra sëbashku janë përzgjedhur nga 24 studentë, të cilët përbëjnë rreth 60% të totalit të numrit



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

This project has been funded with support from the European Commission.

This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein

të studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Ndërsa profilet më pak të përzgjedhur janë profilet: Auditim i Institucioneve Financiare dhe profili Menaxhim dhe Vlerësim projektsh, me nga 4 studentë secili, rreth 18 % e totalit.

Përzgjedhja e njërit profil në raport me profilet e tjera lidhet kryesisht me interesat akademike të studentëve, sikurse dhe me profilet e tyre të punësimit. Fakti se të 5 profilet e ofruara në këtë program studimi janë përzgjedhur nga studentët, është një tregues se mënyra e hartimit dhe përmbajtja e kurrikulës është e përshtatshme për një diapazon të gjerë interesash akademike dhe profesionale. Ky mund të konsiderohet si një ndër sukseset kryesore të këtij programi studimi, duke garantuar në këtë mënyrë edhe qëndrueshmërinë e programit edhe në vitet e ardhshme.

2. Studentët që vijnë nga administrata publike

Në programin e studimit Master Profesional 'Audit', 24 prej 42 studentëve në total (rreth 60 %) janë nëpunës të administratës publike, si në nivel qendror ashtu dhe në nivel lokal. Institucionet në të cilat janë të punësuar studentët e regjistruar në këtë program studimi, janë:

1. Kryeministria;
2. Kuvendi;
3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
4. Agjencia e Prokurimit Publik;
5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
6. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
7. Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare;
8. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
9. Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural;
10. Autoriteti i Aviacionit Civil;
11. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
12. Prokuroria e Rrethit Gjyror;
13. Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
14. Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
15. Muzeu Kombëtar;
16. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
17. Bashkia e Tiranës.

Lista e institucioneve prej nga vijnë studentët e regjistruar në këtë program studimi është e larmishme dhe varion nga institucionet kryesore në nivel qendror e deri tek institucionet në nivel rajonal dhe lokal. Një shpërndarje e tillë dëshmon si diversitetin e studentëve të regjistruar, ashtu edhe një nivel të lartë të përfaqësimit të administratës publike në nivele të ndryshme. Këto të dhëna dëshmojnë përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të projektit lidhur me hartimin dhe implementimin e një kurrikule bashkëkohore për ngritjen e kapaciteteve të administratës publike. Studentët e përfshirë në këtë program studimi në vitin akademik 2018-2019, do shërbejnë edhe për përhapjen e informacionit tek kolegët e tyre në administratën publike, të cilët do të jenë target grupi për vitet e ardhme akademike. Përzgjedhja e këtij programi studimi edhe nga studentë të cilët aktualisht nuk janë të punësuar në administratën publike është tregues se ai vlerësohet si program i përshtatshëm si për ata që punojnë në sektorin privat, ashtu edhe për ata individë të cilët mund të kenë në objektivat e tyre profesionale angazhimin e mëvonshëm në administratën publike.



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

This project has been funded with support from the European Commission.

This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein

3. Kurrikula e programit të studimit

Programi Master Profesional 'Audit' ka në përmbajtje të kurrikulës lëndët si më poshtë vijon:

Master Profesional AUDIT- 60 ECTS			
Nr.	Sem	Emri i lëndës	ECTS
A - Lëndë Bazë/ 5-10%/6 ECTS			
1	1	Metoda kërkimi të avancuara	6
B - Lëndë Karakterizuese të Programit 30-40% /18 ECTS			
1	2	Auditim Financiar	6
2	1	Analizë dhe raportim financiar	6
3	1	Kontabilitet Financiar	6
C - Lëndë ndërdisiplinore ose Integruese /20-30%/18 ECTS			
Profili		AUDITIM DHE MENAXHIM RISKU	
1	2	Kontrolli i brendshëm dhe audit	6
2	1	E drejtë e korporatave	6
3	2	Auditimi i Institucioneve Financiare/Bankare	6
Profili		AUDITIMI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE	
1	2	Kontabilitet Bankar	6
2	2	Auditimi i Institucioneve Financiare/Bankare	6
3	1	Tregu Bankar dhe Institucionet e tij	6
Profili		MENAXHIM DHE VLERËSIM PROJEKTESH	
1	1	Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh	6
2	2	Aftësi menaxheriale	6
3	2	Vlerësim Ekonomik Projektsh	6
Profili		KONTABILITET DHE RAPORTIM FINANCIAR	
1	1	Kontabilitet Manaxherial	6
2	2	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)	6
3	2	Auditimi institucioneve financiare/bankare	6
Profili		ADMINISTRIM PUBLIK	
1	2	Vlerësim i Politikave Publike	6
2	1	Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh	6
3	2	Menaxhimi i sektorit publik	6

D - Lëndë plotësuese 10%/ 6 ECTS

1	2	Praktikë / internship**	6
---	---	-------------------------	---

E - Detyrime përmbyllëse 10-20%/12 ECTS

1	1-2	Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm formimi	12
---	-----	--	----

Në vitin akademik 2018-2019 janë aktivizuar të gjitha lëndët e programit Master Profesional 'Audit'. Konkretisht në semestrin e parë janë zhvilluar 7 lëndë, ndërsa në semestrin e dytë janë zhvilluar 9 lëndë. Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi ndjekin lëndët e kategorisë A dhe kategorisë B. Për sa i përket lëndëve të kategorisë C, ato ndiqen nga studentët sipas profilit të zgjedhur prej tyre. Zhvillimi i praktikës, sikurse dhe detyrimet përmbyllëse janë të detyrueshme për të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi.

4. Personeli Akademik i angazhuar në programin e studimit

Në vitin akademik 2018 – 2019, në programin e studimit Master Profesional 'Audit' numri i stafit akademik të angazhuar është 13. Në tabelën në vijim pasqyrohet lista e plotë e stafit akademik të angazhuar, titulli/grada akademike, njësia kryesore dhe njësia bazë në të cilën ata janë të atashuar, lëndët që mbulojnë sikurse dhe forma e punësimit.

Nr.	Stafi akademik	Titulli/G rada	Njësia kryesore	Njësia bazë	Lënda	Forma e punësimit
1	Eda Gemi	PhD.	Shkencave Juridike, Politike dhe MN	Shkenca Sociale të Aplikuara	Metoda Kërkimi të Avancuara	Kohë të plotë
2	Hysen Muceku	Prof. As. Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Ekonomiks dhe Financë	Auditim Financiar Kontrolli i Brendshëm dhe Audit Auditimi i Institucioneve Financiare/Bankare	Kohë të plotë
3	Arbi Agalliu	Prof. As. Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Ekonomiks dhe Financë	Analizë dhe Raportim Financiar Auditimi i Institucioneve Financiare/Bankare	Kohë të plotë
4	Ermela Kripa	Prof. As. Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Ekonomiks dhe Financë	Analizë dhe Raportim Financiar	Kohë të plotë
5	Sokol Ndoka	Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Ekonomiks dhe Financë	Kontabilitet Financiar Kontabilitet Menaxherial	Kohë të plotë

Nr.	Stafi akademik	Titulli/G rada	Njësia kryesore	Njësia bazë	Lënda	Forma e punësimit
6	Arlinda Ymeraj	Prof. As. Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Menaxhim dhe Marketing	Vlerësim i Politikave Publike Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh	Kohë të plotë
7	Orkida Ilollari	Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Qendra për Zhvillimin e Qendrueshëm	Tregu Bankar dhe Institucionet e tij	Kohë të plotë
8	Edi Spaho	Prof. As. Dr.	Shkencave Juridike, Politike dhe MN	Shkenca Juridike	E Drejtë e Korporatave	Kohë të plotë
9	Anilda Bozdo	Prof. Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Ekonomiks dhe Financë	Kontabilitet Bankar	Kohë të plotë
10	Ermira Qosja	Prof. Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Menaxhim dhe Marketing	Aftësi Menaxheriale	Kohë të plotë
11	Elena Kokthi	PhD.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Menaxhim dhe Marketing	Vlerësim Ekonomik Projektsh	Kohë të plotë
12	Nuriona Berdica	ACCA	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Ekonomiks dhe Financë	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)	Kohë të pjesshme
13	Edlira Margilaj	Dr.	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Menaxhim dhe Marketing	Menaxhimi i Sektorit Publik	Kohë të pjesshme
14	Krisela Ngjela	Auditues Ligjor	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Ekonomiks dhe Financë	Auditimi i Institucioneve Financiare/Bankare	Kohë të plotë

Sikurse vihet re nga të dhënat e tabelës së mësipërme, stafi akademik i angazhuar në vitin akademik 2018 – 2019 në këtë program studimi është i kualifikuar si në aspektin akademik, ashtu edhe eksperiencën profesionale që ata kanë. Nga 14 pedagogë të angazhuar, 2 mbajnë titullin Prof. Dr., 5 mbajnë titullin Prof. As. Dr., 5 kanë gradën Dr. dhe 2 kanë titujt e ekspertit ACCA dhe Auditues Ligjor. Këto të dhëna dëshmojnë nivelin e lartë akademik të stafit të angazhuar. Një element tjetër i rëndësishëm është edhe fakti se vetëm 2 prej pedagogëve (15% e totalit) janë të punësuar më kohë të pjesshme, ndërsa pjesa tjetër (85%) janë staf i punësuar me kohë të plotë pranë Universitetit Europian të Tiranës. Angazhimi i pedagogëve nga fakultete të ndryshme është një tregues i diversitetit të ekspertizave të stafit të këtij programi, duke iu përgjigjur më mirë interesave akademike dhe profesionale të studentëve të regjistruar në këtë program studimi dhe interdisiplinartetit të profileve që programi ofron. Të gjithë këta tregues sasiorë dhe cilësorë përbëjnë një vlerë të shtuar të këtij programi studimi, që pritet të ndikojë në qëndrueshmërinë e tij edhe për vitet në vijim.



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

This project has been funded with support from the European Commission.

This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein

5. Të dhëna sasiore për lëndët e programit

Programi i studimit MP në Audit ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës. Megjithatë, disa nga lëndët në përbërje të kurrikulës së programit burojnë nga departamente të tjera. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e lëndëve nuk ofrohen ekskluzivisht për programin MP Audit, por janë pjesë edhe e kurrikulave të programeve të tjera të UET. Ndaj në të dhënat e tabelës në vijim, është pasqyruar si numri i programeve ku shfaqet lënda, numri i përgjithshëm i studentëve që e kanë frekuentuar, dhe sa prej tyre i përkasin programit MP Audit.

Ndërtimi i programeve synon të ofrojë si thellim të njohurive në fushën përkatëse të studimit, ashtu edhe njohuri në fusha interdisciplinare, duke i dhënë mundësi studentëve të zgjedhin një profil sa më pranë interesave të tyre akademike dhe profesionale, pavarësisht programit të përzgjedhur. Ky element përbën një vlerë të shtuar të programit të studimit, vlerësimi i bërë si nga studentët por edhe aktorët e tregut të punës, të cilët vlerësojnë diversitetin e njohurive dhe aftësive të përfutuara nga studentët. Studentët e regjistruar në programin Master Profesional 'Audit', ndjekin së bashku, në të njëjtën klasë lëndët e kategorive A dhe B të programit, dhe ndahen sipas profilit të zgjedhur në lëndët e kategorisë C.

Tabela në vijim paraqet disa të dhëna për lëndët që janë pjesë e programit MP Audit.

Nr.	Emri i lëndës	Nr. programeve ku ofrohet lënda	Nr. fashave që zhvillohet lënda	Nr. total i studentëve	Nr. Studentëve MP 'Audit'
1	Metoda kërkimi të avancuara	20	5	856	42
2	Auditim Financiar	1	1	42	42
3	Analizë dhe raportim financiar	4	2	200	42
4	Kontabilitet Financiar	1	1	42	42
5	Kontrolli i brendshëm dhe audit	3	1	29	12
6	E drejtë e korporatave	3	1	70	12
7	Auditimi i Institucioneve Financiare/Bankare	4	2	175	26
8	Kontabilitet Bankar	3	1	94	4
9	Tregu Bankar dhe Institucionet e tij	4	1	54	4
10	Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh	9	2	61	16
11	Aftësi menaxheriale	11	2	103	4
12	Vlerësim Ekonomik Projektsh	7	1	29	4
13	Kontabilitet Menaxherial	3	2	136	10
14	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar	5	2	159	10
15	Vlerësimi i Politikave Publike	4	1	35	12
16	Menaxhimi i sektorit publik	6	1	35	12

6. Rezultatet e vlerësimit të lëndëve dhe pedagogëve nga studentët

Gjatë semestrit të parë dhe të dytë të vitit akademik 2018 – 2019, studentët kanë shprehur vlerësimet e tyre lidhur me programin Master Profesional 'Audit', nëpërmjet plotësimit të *Formatit për vlerësimin e lëndës dhe pedagogut*, format i cili është përgatitur në kuadër të projektit FINAC dhe i është vënë në dispozicion në gjuhën shqipe, studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Format i vlerësimit është plotësuar duke ruajtur anonimat e studentëve, me qëllim që ata të shprehin hapur dhe me sinqeritet vlerësimin e tyre.

Tabela në vijim paraqet në përmbledhje të vlerësimeve të studentëve., për secilën nga lëndët e zhvilluara gjatë semestrit të parë dhe semestrit të dytë.

Vlerësimi për lëndët dhe pedagogët, viti 2018 - 2019, Semestri I						
Nr.	Emri i lëndës	Nr. Studentëve	Nr. Pyetësorëve		Pika të forta	Pika të dobëta/ Rekomandime
1	Metoda kërkimi të avancuara	42	16	38%	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet e përdorura • Kriteret e vlerësimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Nevoja për lektorë të ftuar
2	Analizë dhe raportim financiar	42	15	36%	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet e përdorura • Kriteret e vlerësimit • Komunikimi 	
3	Kontabilitet Financiar	42	15	36%	<ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia • Materialet e përdorura • Komunikimi 	
4	E drejtë e korporatave	12	8	67%	<ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi • Transparenca në vlerësim • Mënyra e mësimdhënies 	<ul style="list-style-type: none"> • Më shumë materiale në gjuhën shqipe • Nevoja për lektorë të ftuar
5	Tregu Bankar dhe Institucionet e tij	4	1	25%	<ul style="list-style-type: none"> • Kriteret e vlerësimit • Lektorët e ftuar 	<ul style="list-style-type: none"> • Materiali duhet të jetë më i plotë
6	Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh	16	5	31%	<ul style="list-style-type: none"> • Materiali i përdorur • Komunikimi 	<ul style="list-style-type: none"> • Transparenca lidhur me kriteret e vlerësimit
7	Kontabilitet Menaxherial	10	2	20%	<ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia • Materialet e përdorura • Komunikimi 	
8	Auditim Financiar	42	7	16%	<ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia • Materialet e përdorura • Komunikimi 	
9	Kontrolli Brendshëm dhe Audit	12	11	92%	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet e përdorura • Komunikimi • Mësimdhënia 	<ul style="list-style-type: none"> • Më shumë shembuj praktik
10	Auditimi i Institucioneve Financiare/Bankare	26	23	89%	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet e përdorura • Komunikimi • Mësimdhënia 	<ul style="list-style-type: none"> • Më shumë shembuj praktik
11	Kontabilitet Bankar	4	1	25%	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet e përdorura 	

					<ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi • Mësimdhënia 	
12	Aftësi Menaxheriale	4	1	25%	<ul style="list-style-type: none"> • Kriteret e vlerësimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Nevoja për lektor të ftuar
13	Vlerësim Ekonomik Projektsh	4	2	50%	<ul style="list-style-type: none"> • Materiali i përdorur • Komunikimi • Lektorët e ftuar 	
14	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar	10	1	10%	<ul style="list-style-type: none"> • Materiali i përdorur 	<ul style="list-style-type: none"> • Më shumë shembuj praktik • Transparenca lidhur me kriteret e vlerësimit
15	Vlerësim i Politikave Publike	12	2	17%	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet e përdorura • Komunikimi • Mësimdhënia 	
16	Menaxhim i Sektorit Publik	12	3	25%	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet e përdorura • Komunikimi • Mësimdhënia 	

Nga analizimi i pyetësorëve, rezulton se studentët e programit Master Profesional 'Audit' kanë dhënë vlerësime pozitive lidhur me ecurinë e këtij programi, si për lëndët ashtu edhe për stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie. Disa nga elementët që studentët vlerësojnë më pozitivisht janë:





- Mësimdhënia;
- Materialet e përdorura;
- Komunikimi i pedagogut të lëndës;
- Transparenca në vlerësim.


Disa nga rekomandimet në kuadër të përmirësimit janë:


- Shtimi i numrit të lektorëve të ftuar;
- Ndërthurja e vazhdueshme e aspekteve teorike me raste praktike.


Të dhënat e gjeneruara nga pyetësorët janë bërë pjesë e diskutimeve në mbledhjet e departamentit, sikurse dhe në komunikime të personalizuara të përgjegjësit të departamentit me pedagogun e lëndës për çështje specifike.

7. Rezultatet e studentëve në provimet e lëndëve të semestrit të parë dhe të dytë, viti akademik 2018-2019









8. Numri i studentëve të cilët kanë nisur punimin e diplomës

Bazuar në legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë, sikurse dhe në rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës, mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes:

- Paraqitjes së një punimi diplome - i cili duhet të jetë në formën e një projekti profesional me karakter aplikativ/praktik në rastin e programeve Master Profesional;
- Dhënies së një provimi të përgjithshëm përfundimtar (PPP).

Mundësinë për të përzgjedhur alternativën e parë, e kanë ata studentë të cilët kanë një mesatare në hyrje të barabartë ose më të lartë se 7.5. Alternativa e dytë është e detyrueshme për studentët me mesatare më të ulët. Edhe studentët me notë mesatare mbi 7.5 kanë të drejtë të zgjedhin këtë alternativë, në vend

të aplikimit për përgatitjen e një punimi diplome. Numri i studentëve të regjistruar në programin Master Profesional 'Audit', të cilët kanë përzgjedhur alternativën e punimit të diplomës është 4. Pjesa tjetër e studentëve do t'i nënshtrohen dhënies së provimit të përgjithshëm përfundimtar, i cili në bazë të rregullores ka formën e një *case study*, të lidhur ngushtë me lëndët e profilit të tyre të studimeve.

Studentët të cilët kanë dorëzuar punim diplome/projekt të aplikuar

<i>Nr .</i>	<i>Emri dhe Mbiemri I studentit</i>		<i>Titulli I punimit</i>	<i>Emri I udhëheqësit</i>
1	Saka	Anxhela	Pjesëmarrja e biznesve në programet e nxitjes së punësimit	Dr. Sokol Ndoka
2	Haxhijaj	Xhenis		
3	Bahushi	Kristiana		

9. Aktivitetet në kuadër të përmirësimit dhe qëndrueshmërisë së programit MP 'Audit'

Nga eksperiencia e deritanishme konstatohet se studentët aktual nuk kanë njohuritë bazë të fushës së menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të fushës së auditit, prandaj dhe po përpiqemi që krahas njohurive specifike të avancuara, të marrin edhe njohuritë bazë të fushës së auditit dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Veprimtari të mëtejshme të rëndësishme janë njohja dhe zbatimi i bazës metodologjike të sistemit të auditimit publik që është përgatitur nga Ministria e Financave (institucioni përgjegjës i kësaj fushe), ku ne kemi orientuar studentët në website-t përkatëse me qëllim që të njihen me dokumentet përkatës, si: manuale auditit dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit, metoda dhe teknika të auditimit, metodologji të sigurimit të cilësisë, etj., si dhe zbatimi i tyre në veprimtaritë praktike të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të fushës së auditimit të brendshëm publik.

Një aktivitet tjetër i parashikuar është dhe pasurimi i literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar, ku me interes do të ishte edhe përkthimi në gjuhën shqipe i teksteve përkatëse të fushës së auditimit të jashtëm (financiar) dhe të auditimit të brendshëm. Në kuadër të përmirësimit dhe qëndrueshmërisë së programit është parashikuar edhe përfshirja e sa më shumë lektorëve të ftuar që vijnë nga Institucione të rëndësishme të Administratës Publike sikurse janë: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Auditimit të Ministrisë së Financës apo drejtoritë e Auditimit nga Institucionet Financiare (Bankat) në mënyrë që të sigurohet një ndërthurje e vazhdueshme e aspekteve teorike me raste praktike.

10. Aktivitetet në kuadër të tërheqjes së studentëve për vitin akademik 2019 - 2020

Informimi dhe ndërgjegjësimi i studenteve dhe individëve të tjerë të interesuar për të ndjekur programet Master realizohet nëpërmjet këtyre formave:

- Organizim, në mjediset e UET-it, i takimeve informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjësuese me grupe studentësh që shfaqin prirje për vijimin e studimeve në ciklin e dytë;
- Takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e këtyre programeve;



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

This project has been funded with support from the European Commission.

This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein

- c. Përgatitje e materialeve informuese – sqaruese – ndërgjegjësuese si: fletëpalosje, postera, broshura etj., dhe të atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promovionale etj;
- d. Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të UET-it të “Javëve të regjistrimit”, gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve për ciklin e dytë, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe pajisen me dokumentacionin përkatës.
- e. Intensifikimi i bashkëpunimit me aktorët dhe institucionet e angazhuara gjatë vitit akademik 2018-2019, sikurse dhe zgjerimi i këtij rrjeti.

UET ka si politikë të vetën këshillimin akademik për studentët aktual dhe ata potencial. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është asistimi i studentëve në arritjen e një objekti edukimi të cilat përkojnë me interesat personale, vlerat dhe aftësitë e tyre. Për këtë arsye Universiteti ka vënë në dispozicion personelin akademik të fushës (dy këshillues karriere) dhe zyra që merren me këshillimin akademik të studentëve. Për Masterin Profesional në Audit, është ngritur një grup pune i posaçëm i përbërë nga ekspertë të fushës për të bërë këshillimin akademik dhe të karrierës së studentëve ekzistues edhe atyre të ardhshëm. UET ka bërë disa takime me institucione të ndryshme publike dhe private duke ju prezantuar ofertën akademike lidhur me Auditimin, menaxhimin financiar dhe kontrollin për të ngritur kapacitetet e duhura në këtë fushë. Gjithashtu, studentët e përfshirë në këtë program studimi në vitin akademik 2018-2019, po shërbejnë për përhapjen e informacionit tek kolegët e tyre në administratën publike, të cilët janë dhe target grupi kryesor për vitet e ardhme akademike.



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

*This project has been funded with support from the European Commission.
This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein*